



Letërnjoftimi i komunave 2025



Letërnjoftimi i Komunave

Shtator 2025

— Përmbajtja

Hyrje	5
1. Demografia dhe territori	6
1.1 Popullsia	6
1.2 Territori	8
1.3 Dendësia e popullsisë	9
2. Arsimi	9
3. Mirëqenia sociale	14
4. Administrata	15
5. Buxheti	17
6. Ekonomia	22
7. Shërbimet publike	25
8. Transparenca buxhetore	27

Përmbledhje ekzekutive

- Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (2024) dhe vlerësimit në katër komuna veriore, Kosova ka gjithsej 1,602,515 banorë, që paraqet një rënie prej 177,605 banorësh apo 10% më pak krahasuar me vitin 2011. Rënie të popullsisë kanë shënuar 28 komuna, ndërsa vetëm 9 komuna kanë shënuar rritje të popullsisë. Rënia më e madhe vërehet në Komunën e Zveçanit (-62%), Zubin Potokut (-49%), dhe Kamenicës (-37%), ndërsa komunat me rritjen më të madhe të popullsisë janë Komuna e Fushë Kosovës (84%), Parteshit (81%), Graçanicës (73%), dhe Shtërpçës (55%).
- Aktualisht, shpërndarja e popullsisë në zonat urbane dhe rurale është e barabartë, me nga 50%. Krahasuar me vitin 2011, pjesëmarrja e popullsisë në zonat urbane është rritur me 12 pikë përqindjeje, ndërsa në zonat rurale është zvogëluar me të njëjtin nivel.
- Të dhënat tregojnë se 64% e banesave/ndërtesave në Kosovë janë të shfrytëzuara ndërsa 36% janë të pashfrytëzuara. Krahasuar me vitin 2011, numri i banesave/ndërtesave të pashfrytëzuara është rritur me 7 pikë përqindjeje.
- Komuna e Mitrovicës së Veriut është komuna me dendësinë më të madhe të popullsisë, gjithsej 1,584 banorë në një kilometër katror, ndjekur nga Komuna e Fushë Kosovës me 770 banorë për kilometër katror. Komuna me dendësinë më të vogël të popullsisë është Komuna e Zubin Potokut me vetëm dhjetë banorë në një kilometër katror.
- Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (arsim parafillor, fillor, mesëm të ulët dhe mesëm të lartë) ka pësuar një rënie të vazhdueshme gjatë viteve. Gjatë katër viteve shkollore të fundit, nga viti 2021/22 deri në 2024/25, numri i nxënësve në nivel vendi është zvogëluar për 28,670 persona apo 9%. Me përjashtim të Komunës së Fushë Kosovës, e cila ka pasur rritje të numrit të nxënësve për 10% dhe Komunës së Junikut me 6%, të gjitha komunat tjera kanë pësuar rënie të numrit të nxënësve krahasuar me vitin shkollor 2021/22.
- Personeli arsimor parauniversitar (mësimdhënësit, personeli administrativ dhe personeli ndihmës) në katër vitet e fundit është zvogëluar me rreth 2% apo 717 persona. Gjithsej 25 komuna kanë shënuar rënie të numrit të personelit arsimor. Rënia më e madhe vërehet në Komunën e Junikut me 31%, ndërsa nga komunat të cilat kanë shënuar rritje të personelit arsimor, dominon Komuna e Fushë Kosovës me 19% rritje.
- Për vitin shkollor 2024/2025, raporti nxënës-mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në nivel vendi është 12 nxënës për një mësimdhënës. Komunat me raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës janë Komuna e Fushë Kosovës, Prishtinës, dhe Mitrovicës së Jugut. Në anën tjetër, komunat me raportin më të ulët nxënës-mësimdhënës janë Komuna e Leposaviqit dhe Komuna e Zveçanit.
- Sipas të dhënave të fundit (qershor 2025), numri i familjeve në Kosovë të cilat përfitojnë nga skemat e ndihmës sociale është 16,759 familje, me gjithsej 65,026 anëtarë. Krahasuar me vitin 2021, ky numër ka shënuar një rënie prej 37,878 personash (ose 37%).
- Sipas të dhënave të punësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), numri i të punësuarve në sektorin publik në nivel lokal në vitin 2024 ishte 43,733 persona. Komuna me numrin më të madh të të punësuarve është Komuna e Prishtinës, ndjekur nga Prizreni, Ferizaji dhe Gjilani. Komunat me më së paku të punësuar në sektorin publik janë Leposaviqi, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Klokoti dhe Parteshi.
- Në 30 komuna të analizuara, ekzistojnë gjithsej 337 drejtori komunale, prej tyre, 243 (72%) të udhëhequra nga burrat dhe 94 (28%) të udhëhequra nga gratë. Hendeku më i madh gjinor vërehet në Komunën e Klinës dhe Novobërdës ku të gjitha drejtoritë udhëhiqen nga burrat. Pjesëmarrje më e lartë e grave në udhëheqje të drejtorive komunale vërehet në Komunën e Obiliqit me gjashtë drejtori të udhëhequra nga gratë dhe pesë nga burrat, si dhe në Komunën e Hanit të Elezit me pesë drejtori të udhëhequra nga

gratë dhe katër nga burrat.

- Të hyrat vetanake të komunave vazhdojnë të mbesin të ulëta. Në buxhetin e vitit aktual, nga gjithsej 788 milionë euro, 115 milionë prej tyre (15%) planifikohen të inkasohen nga komunat. Krahasuar me vitin paraprak, nga 742 milionë euro buxhet që komunat kishin në dispozicion, vetëm 105 milionë prej tyre (14%) ishin të hyra vetanake të komunave.
- Komunat e Kosovës po përballen me nivel të lartë të borxheve të pambledhura. Gjithsej 34 komuna të Kosovës kanë borxh të pambledhur me vlerë rreth 276.8 milionë euro. Komuna me nivelin më të lartë të borxheve të pambledhura është Prishtina me gjithsej 85.6 milionë euro, ndjekur nga Prizreni me 27 milionë euro, Ferizaji me afro 19 milionë euro dhe Peja me 18.2 milionë euro.
- Në vitin 2024, komunat e Kosovës po ashtu u përballën me rritje të shpenzimeve si pasojë e obligimeve përmbarimore dhe gjyqësore. Vlera e shpenzimeve arriti në 86.4 milionë euro, që është dyfishi i vlerës krahasuar me vitin 2023, dhe rreth 137% rritje krahasuar me vitin 2022. Në disa prej komunave, si në Komunën e Deçanit, Vitisë, Kamenicës, Shtërpcës, Podujevës, Suharekës dhe tjera, shpenzimet ndaj përmbaruesve dhe gjykatave tejkalojnë vlerën e të hyrave vetanake të këtyre komunave.
- Komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të bizneseve të regjistruara, me 3,414 (28%) të gjithsej bizneseve të reja gjatë vitit 2023, ndjekur nga Ferizaji me 1,042 (9%) dhe Prizreni me 912 (7%). Po ashtu, këto janë komunat me numrin më të madh të bizneseve të shuara gjatë të njëjtit vit (2023).
- Lidhur me aktivitetin ekonomik të bizneseve sipas komunave gjatë vitit 2024, të dhënat tregojnë që komunat me vlerën më të madhe të qarkullimit të bizneseve janë Komuna e Prishtinës me 42% të gjithsej qarkullimit, ndjekur nga Graçanica me 10%, Ferizaji me 7% dhe Prizreni me 6%.
- Buxheti i të gjitha komunave të Kosovës për vitin 2025 është 788 milionë euro. Për dallim nga viti paraprak, buxheti është rritur me 45 milionë euro (6%). Komunat të cilat kanë rritje të buxhetit me mbi 10% krahasuar me vitin paraprak janë Skënderaj (39%), ndjekur nga Parteshi (11%) dhe Ferizaji (10%). Komunat që kanë shpenzuar 100% të mjeteve të dedikuara për investime kapitale në vitin 2024 janë: Suhareka, Malisheva dhe Ferizaji. Por, nga kjo vlerë, nuk dihet saktë se sa mund të jenë pagesa të obligimeve përmbarimore, që jo-doemos ndërlidhen me realizim të projekteve konkrete kapitale. Ndërsa komuna me përqindjen më të ulët të shpenzimit të buxhetit të dedikuar për investime kapitale është Komuna e Leposaviqit (2%).
- Sipas të dhënave të ATK-së, në vitin 2024 në Kosovë kanë qenë të punësuar gjithsej 396,814 persona. Krahasuar me vitin paraprak, numri i të punësuarve është rritur për 9,349 persona apo rreth 2%. Komunat me numrin më të madh të të punësuarve janë Prishtina, Ferizaji, Prizreni, Peja, Gjilani dhe Graçanica. Ndërsa, komunat me numrin më të vogël të të punësuarve janë Parteshi, Zveçani dhe Ranillugu.
- Sipas raportit të fundit të performancës (2023) së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha kryesore me gjithsej 93 tregues të matjes është 58%. Shërbimet publike administrative, ndjekur nga transparenca komunale, shfaqin performancë më të lartë krahasuar me fusha si përfaqësimi gjinor dhe infrastruktura rrugore të cilat vlerësohen dobët.
- Transparenca buxhetore e komunave për vitin 2024, matur nga Instituti GAP, vlerësohet me 61 pikë. Ky vlerësim është më i lartë se vlerësimi i vitit 2023 për 3.5 pikë, apo 6% më shumë. Komunat me vlerësimin më të lartë, përkatësisht me nga 100 pikë, janë Komuna e Kaçanikut, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Rahovecit, Shtimes, Skënderajit dhe Vushtrrisë. Komunat me vlerësim zero pikë në transparenca buxhetore janë Komuna e Zubin Potokut dhe Zveçanit.

Mungesa e analizës së strukturuar dhe krahasimit të të dhënave në fushat të cilat janë kompetencë e pushtetit lokal paraqet sfidë për komunat e Kosovës, duke ndikuar negativisht në procesin e marrjes së vendimeve të bazuara në evidencë dhe në gjendjen reale në terren. Për të adresuar këtë boshllëk, Instituti GAP publikon serinë e raporteve "Letërnjoftimi i Komunave", të cilat trajtojnë zhvillimet kryesore në komunat e Kosovës duke ofruar të dhëna krahasuese ndër vite dhe mes fushave të ndryshme.

Ky raport shfaq trendin e zhvillimeve kryesore në nivel komunal duke përfshirë fusha si demografia, territori, arsimi, mirëqenia sociale, administrata, buxheti, ndërmarrësia, shërbimet publike dhe transparencë. Të dhënat e përmbledhura në këtë raport shfaqin ndryshime të theksuara demografike dhe ekonomike në komunat e Kosovës. Rënia e përgjithshme e popullsisë, migrimi i brendshëm drejt zonave urbane, si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve paraqesin sfida për planifikim të qëndrueshëm lokal. Megjithatë vlera e buxhetit të komunave ka shënuar rritje graduale gjatë dekadës së fundit, të hyrat vetanake vazhdojnë të jenë të ulëta dhe niveli i borxheve të pambledhura mbetet i lartë. Për më tepër, hendeku gjinor në punësim dhe pozita udhëheqëse, së bashku me performancën e ulët në fusha kyçe, dëshmojnë nevojën e përmirësimit të qeverisjes lokale përmes politikave më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Metodologjia e këtij raporti bazohet në të dhëna zyrtare të publikuara nga institucionet relevante, përfshirë Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Këto të dhëna analizohen duke u fokusuar në identifikimin e trendeve dhe dallimeve ndërkomunale në fusha të ndryshme si demografia, arsimi, ekonomia, administrata publike, buxheti dhe të tjera të ngjashme.

1. Demografia dhe territori

1.1 Popullsia

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (2024) dhe vlerësimit në katër komunat veriore, numri gjithsej i banorëve në Kosovë është ekuivalent me 1,602,515 banorë.¹ Krahësuar me regjistrimin e popullsisë së vitit 2011 (1,780,021 banorë),² popullsia në Kosovë është zvogëluar për 177,506 banorë apo rreth 10%.

Në nivel të komunave, rënie e popullsisë është shënuar në 28 komuna, ndërsa në vetëm 9 komuna është shënuar rritje e popullsisë.³ Komunat me rritjen më të madhe të popullsisë janë: Komuna e Fushë Kosovës (84%), Parteshit (81%), Graçanicës (73%), dhe Shtërpcës (55%). Ndërsa, komunat me rënien më të madhe të popullsisë janë: Komuna e Zveçanit (-62%), Zubin Potokut (-49%), Kamenicës (-37%), Ranillugut (-36%) dhe Junikut (-35%).

Fig. 1 Ndryshimi i popullsisë sipas komunave, krahasimi në 2011 dhe 2024



Burimi: GAP bazuar në të dhëna të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)

Bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë (2024), shpërndarja aktuale e popullsisë në zonat rurale dhe urbane në Kosovë paraqitet pothuajse e barabartë, me 795,627 banorë (50%) që jetojnë në zona urbane dhe 789,939 banorë (50%) në zona rurale.⁴ Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë i vitit

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024](#). 2025. Shënim: Numri i popullsisë është bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2024, përfshirë Vlerësimin e Popullsisë për katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovica e Veriut.

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2011](#), f.37., 2013.


3 Këtu nuk përfshihet Komuna e Mitrovicës së Veriut, pasi që procesi administrativ i themelimit të komunës nisi pas vitit 2011 dhe nuk ishte e përfshirë në census.

4 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024](#). f.11., 2025

2011, 38% e popullsisë jetonte në zona urbane, ndërsa 62% në zona rurale.⁵ Gjatë dekadës së fundit vërehet zhvendosje e brendshme e popullsisë drejt zonave urbane. Si rezultat, pjesëmarrja e popullsisë në zonat urbane është rritur me 12 pikë përqindjeje, ndërsa në zonat rurale është ulur për të njëjtin nivel.

Në nivel lokal, në komunat si Prishtina, Juniku, Mamusha dhe Mitrovica e Veriut, 90% e popullsisë jeton në zona urbane. Për dallim, në komunat si Dragashi, Novobërda, Zubin Potoku dhe Malisheva, mbi 90% e popullsisë jeton në zona rurale.

Fig. 2 Popullsia në zona urbane/rurale sipas komunave, 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë (2024) tregojnë që nga 581 mijë banesa dhe ndërtesa në Kosovë, rreth 64% e tyre janë të shfrytëzuara dhe 36% janë të pashfrytëzuara.^{6,7} Krahësuar me të dhënat e vitit 2011, ku në nivel vendi rreth 71% e banesave/ndërtesave ishin të shfrytëzuara dhe 29% të pashfrytëzuara, numri aktual i banesave të pashfrytëzuara është rritur për 7 pikë përqindjeje.⁸

Komunat me nivelin më të lartë të banesave/ndërtesave të pashfrytëzuara janë Zveçani (81%) dhe Zubin Potoku (60%). Ndërsa, komunat me nivelin më të lartë të banesave të shfrytëzuara janë Mamusha (91%), ndjekur nga Hani i Elezit (82%), Obiliqi (79%), dhe Graçanica (74%).⁹

5 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). ASK Data, [Popullsia sipas gjinisë, llojit të zonës \(urbane / rurale\) dhe moshës 2011](#).


6 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024. [Banesat dhe ndërtesat sipas komunave](#). f.12–13, 2025. Shënim: Në kategorinë banesat/ndërtesat e shfrytëzuara përfshihen 1. banesat/ndërtesat e shfrytëzuara nga një apo më shumë banorë, 2. banesat/ndërtesat e shfrytëzuara nga banorë që nuk janë përfshirë në regjistrim (personel diplomatik, etj), dhe 3. banesat/ndërtesat e shfrytëzuara për përdorim dytësor.

7 Shënim: Sipas ASK, termiologjia 'banesa' dhe 'ndërtesa' përkufizohet si dhomë apo tërësi e dhomave të cilat kanë strukturë të ndarë dhe planifikuar, përfshirë shtëpitë dhe banesat. i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024. Ibid. f.6, 2025.

8 Ibid. f.12.

9 Ibid. f.13–15.

Fig. 3 Shfrytëzimi i banesave/ndërtesave sipas komunave, 2024




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

1.2 Territori

Nga gjithsej 10,901 km² sa është gjithsej sipërfaqja e Kosovës, komuna me territorin më të madh është Komuna e Podujevës me 633 km², ndjekur nga Komuna e Pejës dhe Komuna e Prizrenit me nga 603 km². Ndërsa, komuna me territorin më të vogël është Komuna e Mitrovicës së Veriut me vetëm 5 km².

Fig. 4 Territori i komunave të Kosovës, në km²




Burimi: Ligji nr. 03/L-049 për Financa të Pushtetit Lokal

1.3 Dendësia e popullsisë

Komuna e Mitrovicës së Veriut është komuna me dendësinë më të madhe të popullsisë, me gjithsej 1,584 banorë në një km², ndjekur nga Komuna e Fushë Kosovës me 770 banorë në një km² dhe Komuna e Prishtinës me 443 banorë në një km². Komuna me dendësinë më të vogël të popullsisë është Komuna e Zubin Potokut me vetëm 10 banorë në një km².

Fig. 5 Dendësia e popullsisë sipas komunave, 2024




Burimi: Ligji nr. 03/L-049 për Financa të Pushtetit Lokal dhe Regjistrimi i Popullsisë 2024 (ASK)

2. Arsimi

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (parafillor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë) ka pësuar rënie të vazhdueshme. Gjatë katër viteve të fundit, numri i nxënësve është zvogëluar për 28,670 persona, që përbën një rënie prej 9%.¹⁰ Edhe numri i mësimdhënësve është zvogëluar për 413 mësimdhënës apo rreth 2% në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Fig. 6 Numri i nxënësve dhe mësimdhënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, 2021/23 – 2024/25




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹⁰ Llogaritje të GAP bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Statistikat e Arsimit për vitet 2024/25, 2023/24, 2022/23, dhe 2021/22.

Për vitin shkollor 2024/2025, në nivel vendi, raporti nxënës-mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar është 12 nxënës për një mësimdhënës. Komunat me raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës janë Komuna e Fushë Kosovës, Prishtinës, dhe Mitrovicës së Jugut. Në anën tjetër, komunat me raportin më të ulët nxënës-mësimdhënës janë Komuna e Leposaviqit dhe Komuna e Zveçanit.


Fig. 7 Raporti nxënës-mësimdhënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në katër vitet e fundit, në përjashtim të Komunës së Fushë Kosovës e cila ka pasur rritje të numrit të nxënësve për 10% dhe Komunës së Junikut me 6%, të gjitha komunat tjera kanë pësuar rënie të numrit të nxënësve krahasuar me vitin shkollor 2021/22. Rënia më e lartë është evidentuar në Komunën e Kllklotit dhe të Zveçanit me nga 27%.


Fig. 8 Ndryshimi i numrit të nxënësve në të gjitha nivelet parauniversitare sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Gjithsej personeli arsimor parauniversitar (mësimdhënësit, personeli administrativ dhe personeli ndihmës) në katër vitet e fundit është zvogëluar për 717 persona. Konkretisht, numri i mësimdhënësve është zvogëluar për 413 (2%) mësimdhënës më pak krahasuar me vitin shkollor 2021/22, numri i personelit ndihmës është zvogëluar për 137 (4%) persona, ndërsa personeli administrativ është zvogëluar për 167 (10%) persona.


Fig. 9 Numri i personelit arsimor parauniversitar, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Bazuar në të dhënat sipas komunave, rritje e numrit të personelit arsimor krahasuar me vitin shkollor 2021/22 është shënuar në vetëm pesë komuna, në Komunën e Fushë Kosovës me 19%, Zveçanit me 9%, Leposaviqit me 6%, Zubin Potokut me 5% dhe Ferizajt me 1%. Gjithsej, 25 komuna kanë shënuar rënie në numrin e personelit arsimor, me rënien më të theksuar në Komunën e Junikut me 31%.


Fig. 10 Ndryshimi i numrit të personelit arsimor parauniversitar sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Numri i mësimdhënësve, i cili përbën numrin më të lartë nga të gjithë të punësuarit në sistemin arsimor parauniversitar, është rritur më së shumti në Komunën e Fushë Kosovës me 23%, ndërsa në Komunën e Kaçanikut ky numër ka pasur rënie me -10%.


Fig. 11 Ndryshimi i numrit të mësimdhënësve sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në Komunën e Zveçanit, numri i personelit administrativ është dyfishuar, ndërsa komunat tjera të cilat kanë rritje të personelit administrativ janë Novobërda me 14%, Fushë Kosova me 12%, Malisheva me 6% dhe Rahoveci me 4%. Në gjithsej 22 komuna ka rënie të numrit të personelit administrativ, me Komunën e Mitrovicës së Jugut që ka pësuar rënien më të madhe me 32%, ndjekur nga Komuna e Kamenicës me 26% dhe Komuna e Pejës me 24%.


Fig. 12 Ndryshimi i numrit të personelit administrativ sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Personeli ndihmës, kategoria me më së paku të punësuar në sistemin arsimor parauniversitar, ka shënuar rritje në Komunën e Shtimes me 6%, ka mbetur i pandryshuar në shtatë komuna përgjatë viteve të fundit, ndërsa ka shënuar rënie në 22 komuna me rënien më të madhe të evidentuar në Komunën e Junikut me 60%.


Fig. 13 Ndryshimi i numrit të personelit ndihmës sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Nëse analizohet ndryshimi në numër të personalit arsimor dhe të nxënësve, në Komunën e Fushë Kosovës, ndonëse numri i nxënësve është rritur me 10% gjatë katër viteve shkollore të fundit (2021/22 – 2024/25), numri i personalit arsimor është rritur me 19% për të njëjtën periudhë. Megjithatë, në disa komuna si në Komunën e Zveçanit, numri i nxënësve është zvogëluar me 27% por numri i personalit arsimor është rritur për 9%. Për dallim, Komuna e Junikut është komuna e cila ka shënuar rënien më të madhe të personalit arsimor me 31% në katër vitet e fundit, edhe pse numri i nxënësve është rritur me 6%.

Fig. 14 Ndryshimi i numrit të gjithsej personalit arsimor krahasuar me ndryshimin e numrit të nxënësve sipas komunave, 2021/22 dhe 2024/25




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

3. Mirëqenia sociale

Numri i familjeve në Kosovë të cilat përfitojnë nga skema e ndihmës sociale është 16,759 familje, me gjithsej 65,026 anëtarë.¹¹ Krahësuar me vitin 2021, ky numër ka shënuar një rënie prej 37,878 personave (37%) më pak.


Fig. 15 Numri i anëtarëve të familjeve të cilat pranojnë ndihmë sociale, 2021–2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Sipas komunave, Novobërda dominon me numrin më të madh të qytetarëve të cilët pranojnë ndihmë sociale, ku 22% e gjithsej popullsisë janë nën skemë sociale, ndjekur nga Zveçani (21%), Ranigullu (20%) dhe Zubin Potoku (18%). Në të kundërt, vetëm 1% e qytetarëve të komunave si Prizreni, Graçanica, Prishtina dhe Mamusha përfitojnë nga skema e ndihmës sociale.

Fig. 16 Popullsia përfituese e skemës së ndihmës sociale sipas komunave, 2025




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK); Të dhënat e Mirëqenies Sociale 2024 dhe Vlerësimi i Popullsisë 2024.

¹¹ Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Statistikat e Mirëqenies Sociale [dhjetor 2021](#), [dhjetor 2022](#), [dhjetor 2023](#), [dhjetor 2024](#) dhe [qershor 2025](#).

4. Administrata

Sipas të dhënave të punësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), përkatësisht punësimit në sektorin publik sipas nivelit lokal, gjithsej numri i nëpunësve civilë është 43,733 të punësuar (2024).¹² Krahësuar me vitin paraprak, numri i nëpunësve civilë në komuna është zvogëluar për 181 persona.


Fig. 17 Numri i të punësuarve në sektorin publik në nivel lokal, 2021–2024



Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Komuna me numrin më të lartë të të punësuarve në sektorin publik është Prishtina me gjithsej 4,774 persona, ndjekur nga Prizreni me 3,230 persona, Ferizaji me 2,481 persona dhe Gjilani me 2,380 persona. Komunat me numrin më të ulët të nëpunësve civilë janë Leposaviqi me 100 persona, Mitrovica e Veriut me 120 dhe Zveçani me 128 persona.

Fig. 18 Numri i të punësuarve në sektorin publik sipas nivelit lokal, 2024




Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Në raport me popullsinë, Komuna e Leposaviqit ka numrin më të vogël të nëpunësve civilë për banor, me një nëpunës për 95 banorë, ndjekur nga Mitrovica e Veriut me një nëpunës për 66 banorë dhe Fushë Kosova me një nëpunës për 65 banorë. Në anën tjetër, komunat e Novobërdës dhe Ranillugut kanë numrin më të lartë të nëpunësve civilë në raport me popullsinë, me nga një nëpunës për çdo 11 banorë.

¹² Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), [Raportet vjetore financiare për 2024, 2023, 2022 dhe 2021](#).


Fig. 19 Raporti nëpunës publik – qytetar/e sipas komunave, 2024



Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave

Në katër vitet e fundit, numri i të punësuarve në sektor publik është rritur në Komunën e Fushë Kosovës (27%), Rahovecit (9%), Mamushës (8%), ndërsa është zvogëluar në komunat si Leposaviqi (78%), Mitrovica e Veriut (77%), dhe Zveçani (48%).

Fig. 20 Trendi i punësimit i nëpunësve publik sipas komunave, 2021–2024




Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Në 30 komuna të analizuar, ekzistojnë gjithsej 337 drejtori komunale, prej tyre, 243 (72%) të udhëhequra nga burrat dhe 94 (28%) të udhëhequra nga gratë.¹³ Hendeku më i madh gjinor vërehet në Komunën e Klinës dhe Novobërdës ku të gjitha drejtoritë udhëheqën nga burrat. Shpërndarje e barabartë vërehet në Komunën e Glogocit me gjashtë drejtori të udhëhequra nga gratë, nga gjithsej 12 drejtori. Ndërsa, pjesëmarrja më e lartë e grave në udhëheqje të drejtorive komunale vërehet në Komunën e Obiliqit me gjashtë drejtori të udhëhequra nga gratë dhe pesë nga burrat, si dhe në Komunën e Hanit të Elezit me pesë drejtori të udhëhequra nga gratë dhe katër nga burrat. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të vitit 2021, në

¹³ Faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës, Zubin Potokut, Novobërdës, Mitrovicës së Veriut, Ranillugut, Parteshit, Kllokotit dhe Leposaviqit nuk kanë qenë të qasshme. Korrik, 2025

gjithsej 38 komuna të Kosovës janë 1,004 anëtarë të kuvendeve komunale, prej tyre, 639 anëtarë burra (64%) dhe 365 anëtare gra (36%).¹⁴

Fig. 21 Udhëheqësit/et e drejtorive komunale sipas gjinisë, 2025




Burimi: Faqet zyrtare të komunave, korrik – 2025

5. Buxheti

Buxheti i të gjitha komunave të Kosovës për vitin 2025 është 788 milionë euro.¹⁵ Për dallim nga viti paraprak, buxheti është rritur për 45 milionë euro (6%). Në dhjetë vitet e fundit vërehet një trend i vazhdueshëm rritjeje i buxhetit të komunave, përjashtuar vitet 2021 dhe 2022. Krahasuar me vitin 2015, komunat aktualisht kanë buxhet më të lartë për 366 milionë euro apo rritje për 87%.

Fig. 22 Buxheti i përgjithshëm i komunave, 2015–2025



Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligjet mbi ndarjet buxhetore 2015–2025

¹⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), [Zgjedhjet për kuvende komunale 2021](#).

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, [Ligji NR.08/L-322 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025](#).

Komunat të cilat kanë shënuar rritje të buxhetit në krahasim me vitin paraprak (2024) me mbi 10% janë Komuna e Skënderajt (39%), ndjekur nga Parteshi (11%) dhe Ferizaji (10%).


Fig. 23 Buxheti sipas komunave, 2024 – 2025



Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Sipas strukturës së disa shpenzimeve të buxhetit të komunave, krahasuar me vitin 2024, kategoria e shpenzimeve rrjedhëse është rritur për 28.9 milionë euro (5.5%), pagat dhe shtesat për 11.5 milionë euro (3.2%), subvencionet dhe transferet për 4.7 milionë euro (15.6%) dhe shpenzimet kapitale për 9.8 milionë euro (4.5%).


Fig. 24 Buxheti i komunave i ndarë sipas kategorive kryesore buxhetore, 2015–2025



Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligjet mbi ndarjet buxhetore 2015–2025

Komunat të cilat kanë shpenzuar 100% të mjeteve të dedikuara për investime kapitale në vitin 2024 janë Komuna e Ferizajit, Malishevës dhe Suharekës.¹⁶ Ndërsa komunat me përqindjen më të ulët të shpenzimit të buxhetit të dedikuar për investime kapitale janë Komuna e Leposaviqit me vetëm 2%, Klllokotit me 45%, Prishtinës me 63%, Ranillugut dhe Kamenicës me nga 67%, si dhe Zubin Potokut me 68%.¹⁷

Fig. 25 Niveli i shpenzimit të buxhetit për investime kapitale sipas komunave 2017 -2022



Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligjet mbi ndarjet buxhetore 2015–2025

Të hyrat vetanake të komunave vazhdojnë të mbesin të ulëta. Nga 115 milionë euro të planifikuara për t'u inkasuar në vitin aktual, 38 milionë euro apo 33% e të gjitha të hyrave vetanake të nivelit lokal janë parashikuar të mbledhen vetëm nga Komuna e Prishtinës.¹⁸ Ngjashëm,


¹⁶ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). [Raportet vjetore financiare 2015–2024](#).

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Bazuar në të dhënat e të hyrave vetanake të Komunës së Prishtinës, [Buxheti i miratuar për vitin 2025](#).

nga gjithsej 742 milionë euro buxhet që komunat kishin për vitin 2024, vetëm 105 milionë e tyre (14%) janë inkasuar nga komunat.¹⁹


Fig. 26 Të hyrat e përgjithshme vetanake të komunave, 2015 – 2025



Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligjet mbi ndarjet buxhetore 2015–2025

Komunat e Kosovës po përballen me një nivel të lartë të borxheve të pambledhura. Bazuar në të dhëna të vitit 2024, gjithsej 34 komuna të Kosovës kishin borxh të pambledhur me vlerë rreth 276.8 milionë euro.²⁰ Kjo shifër është 28.3 milionë euro më e lartë krahasuar me vitin e mëparshëm (2023), kur niveli i borxheve të pambledhura ishte 248.5 milionë euro. Komuna me nivelin më të lartë të borxheve të pambledhura është Prishtina me gjithsej 85.6 milionë euro, ndjekur nga Prizreni me 27 milionë euro, Ferizaji me afro 19 milionë euro dhe Peja me 18.2 milionë euro.

Fig. 27 Borxhet e qytetarëve, bizneseve dhe subjekteve tjera ndaj komunave, 2023 – 2024



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

¹⁹ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). [Raporti vjetor financiar 2024](#).

²⁰ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). [Raporti vjetor financiar 2024](#).

Viteve të fundit, komunat janë duke u përballur me një rritje të lartë të shpenzimeve nga obligimet gjyqësore dhe përmbarimore, duke arritur në gjithsej 86.4 milionë euro në vitin 2024, që paraqet një dyfishim krahasuar me vitin 2023 dhe trefishim krahasuar me vitin 2022.²¹ Si burim i këtyre obligimeve përmbarimore janë kontratat e mëhershme, një vendim i Qeverisë i vitit 2008 i cili parashihte pagesë shtesë për të punësuarit në sektorin e arsimit bazuar në nivelin e kualifikimit, dhe kërkesat e shërbyesve civil për kompensime për shujta, pagesë mbi bazë të inflacionit dhe shpenzimet për transport.²² Përveç mësimdhënësëve, kompensime nga gjykata po realizojnë edhe shërbyesit civilë, veçmas për shujta, pagesë mbi bazë të inflacionit dhe shpenzimet për transport. Shpenzimet përmbarimore janë rritur ndjeshëm në të gjitha komunat, pavarësisht madhësisë së tyre. Në Prishtinë ato u rritën nga 6.2 milionë euro në 2022 në 10.5 milionë në 2024, në Suharekë nga 972 mijë në mbi 4.1 milionë, në Skënderaj nga 183 mijë në 2.4 milionë dhe në Vushtrri nga 199 mijë në 3.5 milionë euro. Edhe komunat më të vogla si Graçanica panë rritje të madhe, nga vetëm 260 euro në 2022 në mbi 752 mijë euro në 2024. Kjo gjendje, ku shpenzimet përmbarimore janë të larta, po i kufizon komunat në mundësinë për të realizuar investime kapitale.

Tab. 1 Pagesat nga buxheti i komunave për vitin 2024 përmes Thesarit në bazë të detyrimeve gjyqësore/përmbarimore.

	2024 (në euro)	2023 (në euro)	2022 (në euro)	Përqindja e rritjes mes vitit 2024 krahasuar me 2022
Glllogoc	3,580,866	1,077,771	2,418,201	48%
Fushë Kosovë	3,342,321	1,028,531	147,843	2161%
Lipjan	1,775,177	368,834	354,842	400%
Obiliq	1,330,128	199,209	405,103	228%
Podujevë	3,861,535	1,123,115	1,895,158	104%
Prishtinë	10,582,839	4,757,254	6,218,087	70%
Shtime	869,882	511,946	128,097	579%
Graçanicë	752,986	274,323	260	289510%
Dragash	938,113	483,498	174,075	439%
Prizren	5,573,248	4,023,424	1,688,164	230%
Rahovec	1,779,043	920,102	295,253	503%
Suharekë	4,133,857	615,959	972,282	325%
Malishevë	1,254,073	763,977	812,800	54%
Mamushë	51,323	1,449	91,074	-44%
Deçan	4,388,918	2,149,951	1,404,868	212%
Gjakovë	3,280,432	2,065,307	624,185	426%
Istog	2,349,111	732,475	1,150,495	104%
Klinë	312,908	64,632	54,749	472%
Pejë	7,081,044	5,466,897	1,132,612	525%

²¹ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). [Raporti vjetor financiar 2024](#), f.94

²² Instituti GAP. [Në kërkim të zgjidhjes: Problemet përmbarimore në komuna](#). 2025


Junik	215,400	107,915	63,132	241%
Leposaviq	168,723	–	–	–
Mitrovicë e Jugut	5,042,057	1,168,509	3,615,609	39%
Skënderaj	2,455,186	54,834	183,203	1240%
Vushtrri	3,566,054	2,610,378	199,229	1690%
Zubin Potok	69,066	–	21,893	215%
Zveçan	72,966	31,059	678	10662%
Mitrovicë e Veriut	4,671	17,663	–	–
Gjilan	7,006,316	1,987,677	5,733,917	22%
Kaçanik	736,775	17,656	56,645	1201%
Kamenicë	2,504,310	561,289	364,754	587%
Novobërdë	121,499	83,959	103,266	18%
Shtërpçë	419,416	343,817	132,670	216%
Ferizaj	3,260,412	5,190,665	4,990,519	-35%
Viti	3,308,823	971,428	872,800	279%
Partesh	5,325	204,962	25,474	-79%
Hani i Elezit	204,161	124,389	69,000	196%
Klllokot	29,069	89,043	30,937	-6%
Ranillug	–	7,408	30,184	–
Gjithsej	86,428,033	40,201,304	36,462,057	137%

Burimi: Raportet financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe llogaritje të GAP

6. Ekonomia

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 12,051 biznese të reja ndërsa janë shuar 1,637 biznese.²³ Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë është sektori me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara (2,973) ndjekur nga sektori i prodhimit (1,353) dhe i ndërtimtarisë (1,326).²⁴

Fig. 28 Bizneset e reja dhe të shuara gjatë 2015–2024




²³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë, dhjetor 2024](#).

²⁴ Ibid.

Bazuar në të dhënat e fundit të regjistrimit dhe shuarjes së bizneseve sipas komunave (2023), Prishtina ka numrin më të madh të bizneseve të regjistruara, me 3,414 (28%) të gjithsej bizneseve të reja gjatë 2023, ndjekur nga Ferizaji me 1,042 (9%) dhe Prizreni me 912 (7%). Njëherit këto janë komunat me numrin më të lartë të bizneseve të shuara gjatë të njëjtit vit.²⁵

Fig. 29 Bizneset e reja dhe të shuara sipas komunave, 2023



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Lidhur me aktivitetin ekonomik të bizneseve në komuna gjatë vitit 2024, të dhënat tregojnë që komunat me qarkullimin më të madh të bizneseve janë Komuna e Prishtinës me 42% të gjithsej qarkullimit, ndjekur nga Komuna e Graçanicës me 10%, Ferizajit me 7% dhe Prizrenit me 6%.

Fig. 30 Qarkullimi vjetor i bizneseve sipas komunave, 2024




Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

Sipas të dhënave të ATK-së dhe të raporteve të MFPT-së, në vitin 2024 në sektorin publik dhe privat në Kosovë kanë qenë të punësuar 396,814 persona.²⁶ Krahasuar me vitin paraprak, numri i të punësuarve është rritur për 9,349 persona apo rreth 2%. Komunat me numrin më të lartë të të punësuarve janë Prishtina, Ferizaji, Prizreni, Peja, Gjlani dhe Graçanica. Ndërsa, komunat me numrin më të vogël të gjithsej të punësuarve janë Parteshi, Zveçani dhe Ranillugu.

Në krahasim me të dhënat e vitit paraprak (2023), 14 komuna kanë pësuar rënie të numrit të punëtorëve, me rënien më të madhe të evidentuar në Klllokot (-15%) dhe Partesh (-7%). Ndërsa në disa komuna numri i të punësuarve në 2024 është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin paraprak, veçanërisht në Zveçan (57%) dhe Zubin Potok (46%).

Fig. 31 Numri i të punësuarve sipas komunave, 2023 – 2024




²⁶ Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Open Data. [Të dhënat e Punësimit 2023 dhe 2024](#), si dhe të dhënat nga [raportet financiare](#) të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Shënim: numri i të punësuarve është llogaritur duke përdorur të dhënat për të punësuar në sektorin publik nga MFPT dhe përshtatur ato me të dhënat e të punësuarve në sektorin privat nga ATK.

7. Shërbimet publike

Sipas raportit të fundit të performancës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha kryesore me gjithsej 93 tregues të matjes është 58%.²⁷ Shërbimet publike administrative, ndjekur nga transparenca komunale shfaqin performancë më të lartë krahasuar me fusha si përfaqësimi gjinor dhe infrastruktura rrugore të cilat vlerësohen dobët.


Fig. 32 Performanca e përgjithshme e komunave në 15 fusha kryesore (%), 2023



Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Në kategorinë e shërbimeve publike administrative, ku përveç shërbimeve përfshihet edhe efikasiteti i organeve komunale në adresimin e kërkesave të qytetarëve, Komuna e Deçanit ka arritur nivel maksimal të performancës në realizimin e shërbimeve administrative. Komunat e Parteshit dhe Kllokotit janë komunat të cilat vlerësohen minimalisht (zero pikë) në këtë kategori.

Fig. 33 Performanca e shërbimeve publike administrative sipas komunave (%), 2023




Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

²⁷ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). [Raporti i performancës së komunave të Republikës së Kosovës, Janar-dhjetor 2023](#). 2024

Kategoria e përfaqësimit gjinor përbën kategorinë me performancën më të ulët nga të gjitha fushat tjera. Në performancën e përfaqësimit gjinor matet qasja e të dy gjinive në programet e zhvillimit ekonomik, social dhe aktivitetet tjera. Nga gjithsej 34 komuna për të cilat janë raportuar të dhënat, Komuna e Glllogocit radhitet më mirë nga të gjitha komunat tjera, me vlerësim 75.2%. Parteshi dhe Mitrovica e Veriut vlerësohen më së dobtë në këtë fushë nga të gjitha komunat.


Fig. 34 Performanca e përfaqësimit gjinor sipas komunave (%), 2023



Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Performanca e përgjithshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit është 52.5%. Këtu matet ruajtja e mjedisit natyror, degradimit, ndotjes dhe të ngjashme. Komunat si Dragashi, Istogu, Rahoveci, Suhareka dhe Vitia marrin vlerësim maksimal në përpjekjet e tyre për trajtimin e planeve të mbrojtjes së mjedisit, krahasuar me komunat si Klina, Parteshi, Kaçaniku, Ranillugu, Shtërpca dhe Mitrovica e Veriut të cilat marrin vlerësim minimal, saktësisht zero pikë.


Fig. 35 Performanca e mbrojtjes së mjedisit sipas komunave (%), 2023



Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Performanca e përgjegjshmërisë komunale është vlerësuar me 63.79%, bazuar në vlerësimin e dhjetë treguesve të përgjegjshmërisë komunale për vitin 2023. Brenda kësaj fushe, komunat kanë treguar rezultate të mira sidomos në aspektin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore. Gjithashtu, është evidentuar një angazhim i kënaqshëm në diskutimin e projekt-buxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, çka tregon përfshirje dhe transparencë në këtë proces.

Fig. 36 Performanca e përgjegjshmërisë komunale (%), 2023



Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)


8. Transparenca buxhetore

Sipas llogaritjeve të Institutit GAP, mesatarja e pikëve të transparencës buxhetore për të gjitha komunat e Kosovës për vitin 2024 është 61 pikë (nga gjithsej 100 pikë).²⁸ Ky vlerësim është më i lartë se në vitin 2023 për 3.5 pikë (6%). Vlerësimi maksimal, përkatësisht me nga 100 pikë, i takon Komunës së Kaçanikut, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Rahovecit, Shtimes, Skënderajit, dhe Vushtrrisë. Këto komuna kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formate të lexueshme si 'Excel' ose 'Word'.²⁹ Komunat të cilat janë listuar në kuartilin e ulët të transparencës janë Komuna e Parteshit (20 pikë), Novobërdës (17.5 pikë), Mamushës (15 pikë), Shtërpçës (15 pikë), Ranillugut (12.5 pikë), Graçanicës (10 pikë), Leposaviqit (7.5 pikë), Klllokotit (5 pikë) si dhe Komuna e Zubin Potokut dhe Zveçanit të cilat vlerësohen me zero pikë.

²⁸ Instituti GAP. [Indeksi i Transparencës Buxhetore 2023](#), f.6., 2024

²⁹ Këtu bëjnë përjashtim disa dokumente me përmbajtje tekstuale të cilat publikohen edhe në formate tjera si 'PDF' apo 'dokument i skanuar', por që këto lloje të formateve nuk ndikojnë në pikët maksimale.


Fig. 37 Indeksi i transparencës buxhetore të komunave, 2024



Burimi: Instituti GAP

Transparenca buxhetore në katër vitet e fundit ka shënuar një rritje nga 53.1 pikë në vitin 2021 në 61 pikë në vitin 2024, apo rreth 15%. Megjithatë, vlerësimi më i lartë është shënuar në vitin 2022, me 62.8 pikë. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e përmirësimit të vazhdueshëm të transparencës në dokumentet financiare komunale, përfshirë përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në informacione që janë të rëndësishme për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e qeverisjes dhe mbikëqyrjen e buxhetit publik.

Fig. 38 Transparenca buxhetore e komunave, 2021-2024



Burimi: Instituti GAP

Instituti GAP përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige



KCSF

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

